



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400738/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandohet informimi i përmbaruesit gjyqësor privat F.B. për datat në të cilat është e mundshme mbështetja nga ana juaj e veprimet përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë Nr.6504, datë 27.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në favor të gjyqfituesit Shoqëria "T" sh.p.k..*

**Drejtuar :** **Z.Artan Didi**  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit,

**Z.Altin Shehu**  
Drejtues i Komisarariatit të Policisë Nr.6,

**Për dijeni :** **F.B.**  
Përmbarues Gjyqësor Privat,

**Z. S.D.**  
Administratort i Shoqërisë "T" sh.p.k  
Adresa; Post pritje

**TIRANË**

**TIRANË**

**K E T U**

I nderuar Z.Didi!  
I nderuar Z.Shehu!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e depozituar prej Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.F.B. si dhe administratorit të Shoqërisë "T" Sh.p.k., të cilët ankohen ndaj organeve që ju përfaqësoni për mosmbështetjen e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat, në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.6504, datë 27.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 821, datë 03.04.2013, Gjykata e Apelit, Tiranë, me objekt :

*"Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "K" sh.p.k. t'i lirojë dhe dorëzojë paditësit, Shoqëria "T" sh.p.k. pasurinë me nr. 142/27. Tokë arë + truall, e ndodhur në Muçaj-*

*Tiranë, në zonën kadastrale nr.2726, volumi 8, faqja 78, me sipërfaqe totale 5600m<sup>2</sup>, nga e cila 5000m<sup>2</sup> sipërfaqe tokë truall dhe 2626m<sup>2</sup> ndërtim 1 kat mbi tokë”.*

Referuar akteve të mbajtura në procesin e ekzekutimit dhe vënë në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton se, Përmbaruesi Gjyqësor Privat i çështjes, z.B, me shkresat :

- 1- 384/1 Prot, datë 26.03.2014,
- 2- 420 Prot, datë 07.04.2014,
- 3- 436 Prot, datë 10.04.2014,
- 4- 439 Prot, datë 14.04.2014,
- 5- 466 Prot, datë 17.04.2014,
- 6- 182 Prot, datë 23.04.2014,
- 7- 500 Prot, datë 29.04.2014.

ka kërkuar në referim të nenit 523 të K.Pr.Civile, i cili parashikon se;

*“... Në rast nevoje, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit...”*,

mbështetje në ditën dhe orën e përcaktuar respektivisht në shkresat e lartpërmendura. Në përgjigje të kërkesave të Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.B, për mbështetje në kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë Nr.6504, datë 27.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ju z. Sh në tuajat

- 1- Nr.1538/1 Prot, date 04.04.2014,
- 2- Nr. 1620/1 Prot, datë 08.04.2014,
- 3- Nr. 1778/1 Prot, datë 17.04.2014,
- 4- Nr.1834/1 Prot, datë 23.04.2014,
- 5- Nr.1910/2-k Prot, date 28.04.2014,

jeni shprehur për pamundësinë e mbështetjes së Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.B, për shkak të;

- a- mosplotësimi të dokumentacionit nga ana e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.B, (mungesa e Autorizimit të rinovuar, i cili lëshohet nga Dhoma e Përmbaruesve Gjyqësor Privat);
- b- angazhimit të efektivëve në shërbime të tjera në datën dhe orën e caktuar nga Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.B;
- c- ardhjes së kërkesës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.B, vetëm dy ditë para ditës së kryerjes së veprimeve përmbarimore.

Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z.B, në proces verbalin datë 10.04.2014, të mbajtur në vendin e ekzekutimit, ka prezantuar si shkak të moszekutimit në këtë datë, të vendimit gjyqësor, mosmbështetjen nga ana e punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.6. Këtë qëndrim të shprehur prej Përmbaruesit Gjyqësor Privat, ju z.Sh në Tuajën nr. 1950/1 Prot, date 30.04.2014, e drejtuar Avokatit të Popullit, kundërshtoni duke u shprehur midis të tjerave, se:

*“... situata ishte e tensionua, si dhe duke patur parasysh se prioritetet e punës sonë është siguria e jetës së personit, j’u kërkua përmbaruesit gjyqësor Privat F.B, që këtë mbështetje t’u shtynte për një date tjetër, gjë e cila gjeti mirëkuptim nga ana e tij”.*

Gjithashtu, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, z.B, shprehet në ankesë, se, edhe pse është shtyrë ekzekutimi për më datë 11.04.2014, përsëri mbështetja nga ana e efektivave të këtij Komisaritati ka munguar, me pretendimin se ka një urdhër sekuestro nga një tjetër përmbarues gjyqësor mbi sendin objekt ekzekutimi.

Për gjithë datat, në të cilat është caktuar ora e kryerjes së veprimeve përmbarimore, Përmbaruesit Gjyqësor Privat, z.Beqaraj, nuk i është vënë në dispozicion asnjë akt i cili vërteton angazhimin e efektivave të Komisarariatit të Policisë Nr.6, Tiranë, në datën dhe orën e caktuar, qëndrim ky, i cili, në kuptim dhe zbatim të parashikimit të nenit 606 të K.Pr.Civile, përbën shkak për vendosjen e sanksionit të gjobitjes ndaj personit i cili sipas ligjit është i detyruar të kryej veprime të caktuara, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale.

Në kushtet kur nga ana Policisë së Shtetit, Komisarariatit të Policisë nr.6, Tiranë, nuk është mundësuar mbështetja e përmbaruesit gjyqësor të çështjes z.F.B., në datat dhe orën e përcaktuar, gjykojmë se, për të shmangur cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo nenin 6/1 të Konvetës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor të formës së prerë Nr.6504, datë 27.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 821, datë 03.04.2013, Gjykata e Apelit, Tiranë, është e nevojshme të gjenden rrugë dhe forma të tjera bashkëpunimi me Shërbimin Gjyqësor Përmbarimor Privat për rastin në fjalë, sikurse është informimi i përmbaruesit gjyqësor të çështjes, z.Beqaraj, për ditën dhe orën e mundësimit të mbështetjes së veprimeve përmbarimore nga ana e organeve që ju përfaqësoni. Në kushtet e përballimit të çështjeve të ndryshme nga ana e efektivave të Policisë së Shtetit, Komisarariatit të Policisë nr.6, Tiranë, vëmendje të veçantë duhet të marrë dhe mbështetja e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor i cili ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv si një detyrim kushtetues i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Në këtë kuadër do të vinim theksin në faktin që angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë dhe më konkrete, sidomos në planin e të drejtave të njeriut, të zbatimit të akteve juridike ndërkombëtare dhe të integritimit evropian. Do të ishte cënim i rëndë i autoritetit të shtetit, nëse ankuesi do t'i drejtohej Gjykatës së Strasburgut kundër Shtetit Shqiptar, për një të drejtë të kësaj natyre, ndërkohë që Qeveria në programin e saj e ka konsideruar problem të mprehtë dhe është angazhuar për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktik do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish, pala debitore që ju përfaqësoni duhet të marrë pjesë aktivisht në ekzekutimin e detyrimeve.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në vendimmarrjet e saj ka pranuar se : “... parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.

Më tej, “...ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi e çmon me vend të bëj këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëj rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

## **REKOMANDOJMË**

*Informimin e Përmbauesit Gjyqësor Privat, F.B për ditën dhe orën në të cilën mund të bëhet mbështetja për kryerjen e veprimeve përmbaimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.6504, datë 27.12.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 821, datë 03.04.2013, Gjykata e Apelit, Tiranë, Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhënë në favor të shoqërisë “T” Sh.p.k.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi kthimin e përgjigjes brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKEMBI**

**Konceptoi dhe Daktilografoi**  
**A.Gjoleka**